



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.02.2015, mori:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 – 4266/14, për z. Naim Hyseni – Anëtar i Bordit – Posta e Kosovës Sh.A., për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-4266/14, për z. Naim Hyseni – Anëtar i Bordit – Posta e Kosovës Sh.A., është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Hyseni, është hetuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, si zyrtar i lartë në Postën e Kosovës dhe njëkohësisht bashkëpronar në biznesit privat “Luserna Tekstil”.

Fillimisht zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t’i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëj, në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Hyseni është bindur për kufizimin si bashkëpronar në biznesin privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për ti bërë ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 226/15), me të cilën vërtetohet se ka bërë ndryshimet e nevojshme. Me këtë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

